



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.183/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore, Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, për shkak të Thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si të pabazuar ankesa ZL.Anr. 183/2017 e datës 11.10.2017, e parashtruar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, për shkak të Thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet.

A r s y e t i m

Me datën 11.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren, me të cilën pretendon se me datë 07.08.2017, në ora 21:18, nga baza e të dhënave të Lëvizjes Vetëvendosje në Prizren janë dërguar mesazhe tek komisionert tanë të LDK-së, përmes së cilëve janë ftuar që nën mënyrë të obliguar të marrin pjesë në tubimin elektorale-përgatitor të LVV-së. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika d) dhe g), të Ligjit Nr. 03/L-073. Gjithashtu LDK ka theksuar se më datë 08.10.2017, ka reaguar ndaj këtyre formave propaganduese të LVV, drejtuar komisionerëve dhe kandidatëve për asambleist nga radhët LDK-së, ky model i të bërit fushatë nuk i shërben demokracisë e aq më pak kulturës për politikë- bërje të ndryshme, përkitazi nxit urrejtje mes nesh.

Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 12.10.2017, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, ka theksuar se Departamenti për Mbrojtjen e Votes i Shtabit kryesor të LVV-së me datë 08.10.2017, ka organizuar trajnim në Prizren për vëzhgues dhe komisioner nga radhët e LVV-së, ashtu siç vepron çdo herë para mbajtjes së zgjedhjeve, për të ndihmuar komisioner dhe vëzhguesit nga LVV, të kenë sa më shumë informata në kryerjen e detyrës gjatë procesit zgjedhor, e që ka për qëllim ruajtjen e votës së qytetarit të Republikës së Kosovës dhe nuk ka patur si qëllim tubimin elektorale siç ka pretenduar ankimesi në reagimin e dt.08.10.2017.

Gjithashtu LVV, ka theksuar se nuk është kontestuese fakti që mesazhet e dërguara një ditë më herët janë dërguar nga LVV-ja por duke pas parasysh numrin e madh të vëzhguesve dhe komisionerëve nga radhët e LVV-së është e natyrshme që të ketë gabime teknike tek numrat në listat që ne posedojmë. LVV ka ndërmarr të gjitha masat për të evituar shkeljet e mundshme nga anëtarët, mbështetësit apo kandidatët për zgjedhjet lokale. Me këtë rast kanë përmirësuar listat e vëzhguesve dhe komisionerëve që posedojmë duke evidentuar dy emrat që janë paraqitur në ankesë dhe duke i larguar nga lista numrat e tyre sepse numrat e tyre nuk kanë përkuar me emrat që janë në ankesë. Pra numrat në listën e vëzhguesve dhe komisionerëve përkojnë me emrat të tjerë.

Po ashtu LVV ka theksuar se me dt.08.10.2017, ka mbajtur takim në Prizren me komisioner dhe vëzhgues nga radhët e saj duke bërë publik këtë aktivitet edhe përmes faqes zyrtare, qëllimi i këtij takimi ka qenë mbarëvajtja e procesit zgjedhor gjatë ditës së votimit dhe aspak manipulimi apo shantazh siç pretendohet në ankesën e ankimesit. Dërgimi i atyre mesazheve nuk ka qenë tendencioz dhe i qëllimshëm por ka ndodhur si pasojë e lëshimeve teknike, e që mund të konsiderohet njerëzore dhe e kuptueshme.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politike LVV, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika d) dhe g) të LZP-së, siç ka pretenduar parashtruesi i ankesës, për arsye se mesazhet nuk kanë pasur të bëjnë me tubim elektorale, manipulim apo shantazh por për mbarëvajtja e procesit zgjedhor gjatë ditës së votimit ashtu siç shihet edhe me mesazhet e bashkangjitura ankesës nga ana e ankuesit.

Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në ankesë në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë dhe në kuptim të nenit 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL. Anr.183/2017 më datën 16.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.